



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“High Speed”SH.P.K.
Numri i biznesit 70641259
Pronar – Sadat FERATI
HIGH SPEED SHPK
Podujevë
Rr/Zahir Pajaziti nr.152

Ref:1712/1395/LIC/ni

VENDIM

për ndërprerjen e licencës të operatorit të shpërndarjes High Speed SHPK, me seli në Podujevë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. High Speed SHPK është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregullorën KPM-2016/01, me seli në Podujevë. KPM, me datën 30 tetor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin kabllorë High Speed SHPK.
3. Më datën 15 dhjetor 2017, pronari i operatorit kabllorë High Speed SHPK, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM me anë të e-mailit, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

Arsyetimi

4. Duke marrë parasysh njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes High Speed SHPK, për heqje dorë nga licenca, Zyra Ekzekutive konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së High Speed SHPK.

Vendim

5. Komisioni, në takim in e mbajtur me datën 21 dhjetor 2017, merr vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes High Speed SHPK, ndërsa, shlyerja e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.
6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



21.12.2017

datë